



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
DPSUMK

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.2, Tiranë

Tel/Fax +355 04 225 539

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2006

URDHËR

Nr. 330 datë. 06.07.2006

MBI VENDOSJEN E RREGULLAVE TË DETAJURA PËR KAMPIONIMIN
ZYRTAR DHE MONITORIMIN E DISA SUBSTANCAVE E MBETJEVE NË
KAFSHËT E GJALLA DHE NE PRODUKTET E TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 49 të Ligjit Nr.9308 dt. 04.11.2004 "Për Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar", të Vendimit të Komisionit, 98/179/EC, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

URDHËROJ:

1. Kampionet zyrtare në kafshët e gjalla dhe produktet e tyre, duke përfshirë edhe kriteret e planifikimit, duhet të merren sipas rregullave të detajuara në aneksin e këtij Urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Instituti i Kërkimeve Veterinare për zbatimin e këtij Urdhëri. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Jemin GJANA

ANEKSI

RREGULLAT PËR PROCEDURAT E KAMPIONIMIT ZYRTAR DHE TRAJTIMIT TË KAMPIONEVE ZYRTARE

1.PËRGJEGJËSITË

1.1.Inspektori

Inspektori zyrtar duhet te percaktohet nga Autoriteti Kompetent Qendror per marrjen, regjistrimin pergatitjen dhe organizimin e transportit per kampionet zyrtare ne kushte te pershtatshme.

1.2. Labororet e aprovuara

Analizat e kampioneve zyrtare duhet te behen vetem nga labororet e aprovuar per kontrollin zyrtar te mbetjeve nga Autoriteti Kompetent.

Labororet zyrtar duhet te marrin pjese ne nje proces te kontrollit te cilesise dhe te akreditohen nga organizma nderkombetar.

2.KAMPIONIMI

Aspektet bazë

Cdo here qe merren kampione zyrtare, kampionimi duhet te jete i paparashikuar, i papritur dhe te mos behet ne data te fiksuara dhe jo ne dite te vecanta te javes. Duhet te sigurohet elementi surprize gjate kontrolleve.

Kampionimi duhet te behet me intervale te ndryshme ne harkun e te gjithe vitit, sipas asaj qe eshte parashikuar ne paragrafin 1 te aneksit III te Rregullores Nr.1 date 17.03.2000 “Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore”.

Pa paragjykuar rregulloret e planit te kontrollit te mbetjeve, informacione te tjera duhet te merren ne konsiderate kur zgjdhjen kampionet si per shembull: perdorimi i substancave qe per momentin jane te panjohura, semundjet qe jane shfaqur papritur ne rajone te ndryshme, te dhena per aktivitete fallsifikimi e tje.

2.2.Strategjia e kampionimit

Plani kombetar i monitorimit te mbetjeve ka per qellim:

- (a) te zbuloje te gjithë trajtimet ilegale, si percaktohet ne nenin 2 pika (b) te Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 “Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore”;
- (b) survejimi dhe gjetja e shkaqeve per prezencen e mbetjeve ne ushqimet me origjine shtazore.

2.3.Mbledhja e kampioneve

2.3.1.Përcaktimet

2.3.1.1. Kampion i planifikuar

Kampioni i planifikuar është një kampion i cili merret në përputhje me strategjinë e kampionimit sic përcaktohet në pikën 2.2. më lart.

2.3.1.2. Kampioni i dyshuar

Kampioni i dyshuar është një kampion i cili merret:

- si pasojë e një rezultati pozitiv të kampionit të marrë në përputhje me kërkesat e nenit 5 të Rregullores Nr. 1 datë 17.03.2000 “Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në kafshet e gjalladhe produktet shtazore”

- si pasojë e nenit 11,

- si kërkesë e nenit 24

te kësaj rregulloreje.

2.3.1.3 Kampion i rastësishëm

Një kampion i rastësishëm është një kampion i cili merret pas përpunimit statistikor në mënyrë që të sigurojë të dhëna përfaqësuese.

2.3.2. Mbi planifikimin e fermave të kampionimit

2.3.2.1. Kriteret për përzgjedhjen e kampioneve të planifikuar

Fermtat për kampionimin në ferma mund të zgjidhen duke përdorur njohjet lokale apo çdo informacion tjetër si, tipi i sistemit të majmjes, raca dhe seksi i kafsheve.

Inspektori bën vlerësimin e të gjithë stokut në ferme për të përzgjedhur kafshet që duhen kampionuar. Gjate bërjes së vlerësimit duhet të zbatohen kriteret e mëposhteme;

- të dhënat për përdorimin e substancave farmakologjike aktive

- karakteristikat seksuale sekondare

- ndryshimet në sjellje

- nivelin e njëjtes të zhvillimit në grupet e kafsheve të racave/kategorive të ndryshme

- kafshet me një konformacion të mirë dhe pak të dhjamosura

2.3.2.2. Tipi i kampioneve të planifikuar që duhen mbledhur

Për përcaktimin e substancave farmakologjikisht aktive kampionet duhet të merren sipas asaj që është përcaktuar planin e kontrollit të mbetjeve.

2.3.3. Kampionimi i planifikuar në stabilimentet e përpunimit primar

2.3.3.1 Kriteret për përzgjedhjen

Në kryerjen e verifikimeve mbi karkasat e kafsheve dhe/ose në produktet shtazore që duhen kampionuar, inspektori duhet të zbatojë kriteret e mëposhtme

- seksi, moshë, specia, dhe sistemi i mbareshtimit

- informacionet rreth prodhuesit

- të dhënat për përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive

- praktikën e soministrit të medikamenteve në keto ferma

Kur merren kampione duhen raportuar për të parandaluar një kampionim të shumfishtë nga një prodhues.

2.3.3.2. Tipi i kampioneve të mbledhur

Për zbulimin e substancave farmakologjikisht aktive, kampionet duhet të merren në përputhje me sa është parashikuar në planin e kontrollit të mbetjeve.

2.4. Sasia e kampioneve

Sasia minimale e kampioneve duhet te percaktohet ne planin kombetar te monitorimit te mbetjeve. Ajo duhet te jete e mjaftueshme per ti mundesuar laboratorit te aprovuar per te bere procedurat analitike, te nevojshme per te kompletuarkontrollin dhe analizat konfirmuese.

2.5. Ndarja në nën-kampione

Vetem nese teknikisht e pamundur ose nuk kerkohet ne legjislacionin kombetar, cdo kampion duhet te ndahet ne te pakten dy nen-kampione ekuivalente qe lejojne procedurat e plota analitike. Ndarja mund te behet ne vendin e kampionimit apo ne laborator.

2.6. Kontenitoret e kampioneve

Kampionet duhet te merren ne kontenitore te pershtatshem per te ruajtur integritetin dhe gjurmueshmerine e kampioneve. Ne vecanti, kontenitoret duhet te parandalojne nderrimin, kontaminimin dhe degradimin. Kontenitoret duhet te mbyllen ne menyre zyrtare.

2.7. Raporti i kampionimit

Raporti duhet te behet mbas procedures se kampionimit

Inspektori perfshin te pakten te dhenat e meposhtme ne raportin e kampionimit:

- Adresen e autoritetit kompetent
- emrin e inspektorit apo kodin e identifikimit
- numrin (kodin) zyrtar te kampionit
- daten e kampionimit
- emrin dhe adresen e pronarit apo personin e ngarkuar per kafshet apo produktet shtazore
- emrin dhe adresen e fermes se origjines se kafsheve (kur kampionohet ne ferma)
- numri i regjistrimit te stabilimentit – thretores
- identifikimi i kafshes apo produktit
- lloji i kafshes
- matrica e kampionit
- mjekimi qe eshte bere ne kater javet e fundit perpara kampionimit (kur kampionohet ne ferma)
- substanca apo grupet e substancave per ekzaminim
- shenime te vecanta

Kopje te raportit duhet te parashikohen ne varesi te procedurave te kampionimit.

Raporti i kampionimit dhe kopjet e tij duhet te firmosen te pakten nga inspektori; ne rastin e kampionimit te fermave, fermeri ose i deleguari i tij mund te ftohet qe te firmose raportin origjinal te kampionimit.

Raporti origjinal i kampionimit i mbetet Autoritetit Kompetent, i cili duhet te garantoje qe personat e pa autorizuar nuk mund te kene akses ne kete raport.

Nese eshte e nevojshme, fermeri apo pronari fabrikes mund te informohet per kampionimin e kryer.

2.8. Raporti i laboratorit

Raporti i laboratorit i vendosur nga autoriteti kompetent permban te pakten informacionet e meposhteme:

- adresen e autoritetit kompetent
- emrin e inspektorit apo kodin e identifikimit
- kodin zyrtar te kampionit
- daten e kampionimit
- lloji i kafsheve
- substancat apo grupin e substancave per egzaminim
- shenime te vecanta

Ky raport perpilohet gjate rutines se laboratorit.

2.9. Transporti dhe magazinimi

Plani kombetar i kontrollit te mbetjeve duhet te specifikojë kushtet e pershtatshme per transportin dhe magazinimin e kampioneve per cdo matrice analitike per te siguruar stabilitetin analitik dhe integritetin e kampioneve. Kujdes i vecante duhet bere per kutite e transportit, tempraturat dhe kohen e dorezimit ne laboratorin pergjegjes. Ne rast pa perputhshmerie me kerkesat e planit te kontrollit, laboratori duhet te informoje autoritetin kompetent menjehere.